



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.655/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese Afijete Sada-Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e Zikreta Aliti, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për shkak të bartjes së votave të një kandidat tjetër në vendvotim, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** pjesërisht e bazuar apeli i Zikreta Aliti, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), në vendvotimet: Nr. 2009A/05D në Komunën e Prizrenit.

**III. Refuzohet** e pabazuar pjesa e apelit, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimin: Nr.2004A, në Komunën e Prizrenit.

**IV. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar apelin Anr.655/2021 me datën 05.03.2021, nga Zikreta Aliti, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me të cilën pretendon se në vendvotimet nr.2009A/05D dhe 2004A/05D ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave ashtu që në vendvotimin nr.2009A/05D në shkollën fillore “Mati Llogoreci” ku ka pasur keqpërdorim të detyrës, dhe vjedhje të votave nga ana e komisionerve ku kandidati nga lista jonë me nr.7, në vend që ti shënojnë një votë i kanë shtuar edhe 12 tjera dhe kjo asesi nuk përputhet me votat e fituara nga partia jonë, ku partia i ka fituar vetëm 3 vota. Parashtruesja e apelit pretendon se në vendvotimin nr.2004a, në shkollën fillore “Motrat Qiriazit” është dëmtuar me vota ashtu që komisionarët në atë vendvotim, ankueses me numër 4 ia kanë marr votat, ndërsa kandidatit me numër 7 ia kanë shtuar votat e saj. Apelit ia ka bashkangjitur kopjen e raportit nga vendvotimi nr.2009/05D, dhe parregullsitë në vendvotimin nr.2004a.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është pjesërisht i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Zikreta Aliti, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve nr.2009A/05D dhe nr.2004A në Komunën e Prizrenit, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Me rastin e vendosjes si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij vendimi që ka të bëjë me QV 2004a me të cilën ka pretenduar se ka mungesë të votave nuk qëndron, sepse parashtruesi i apelit nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljen e supozuar në këtë QV, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje dhe bartje të votave të kandidatës në fjalë.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr. 655/2021 më datën 06.03.2021**

**Kryesuesja e Panelit**  
**Kymete Kicaj**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.

